



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 03-03/DPK
Nr. Prot. 01-2629/16
Br. Prot. 01-2629/16
Data 12-08-2016
Datum 12-08-2016
Date 12-08-2016
PRISHTINE

DATË/A:	08/11/2016
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	znj. Zize BUJUPAJ Menaxhere e Zyrës ë Prokurimit në Komunën e Istogut
CC:	z. Haki RUGOVA Kryetar i Komunës së Istogut
NGA/OD/FROM:	<i>Dërk</i> Hasan PRETENI Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Furnizimi- Blerja e Automjetit për udhëtar- Kombi për shërbimin e vakcionimit për nevoja të QKMF-së Istog (i përdorur) "

E nderuara znj. Bujupaj ,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " **Furnizimi- Blerja e Automjetit për udhëtar- Kombi për shërbimin e vakcionimit për nevoja të QKMF-së Istog (i përdorur)**" me numër prokurimi: 633 016 061 121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Furnizimi- Blerja e Automjetit për udhëtar- Kombi për shërbimin e vakcionimit për nevoja të QKMF-së Istog (i përdorur)**" me numër prokurimi: 633 016 061 121, në mënyrë që të respektohen dispozitat

përkatesë të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

A r s y e t i m i

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 08.08.2016, ka nxjerrë vendim me numër protokolli AKK-03-2495/16 për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull " **Furnizimi- Blerja e Automjetit për udhëtar- Kombi për shërbimin e vakcionimit për nevoja të QKMF-së Istog (i përdorur)**" me numër prokurimi: 633 016 061 121, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Istogut.

Komuna e Istogu si Autoritet kontraktues ka përgatitur njoftimin për kontratë e cili njoftim është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me datë 27/07/2016.

Në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit e cila është përgatitur nga ana e Autoritetit Kontraktues, Agjencia ka vërejtur se si kriter për dhënie të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka caktuar kriterin *Tenderi ekonomikisht më i favorshëm*, ndërsa si nën kritere i ka vendosur 1. Oferta financiare të cilën e ka peshuar me 50 %, 2. Të kaluara KM me peshë prej 20 %, 3. Vitin e prodhimit e ka peshuar me 10 %, 4. Fuqia e Motorit është peshuar me 10%, 5. Shpenzimet për KM të derivateve i ka peshuar me 10%.

Lidhur me disa prej nën kritereve, Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se nën kritere të tilla nuk mund të përdorën në asnjë mënyrë si kritere për dhënie të kontratës nga ana e Autoritetit kontraktues.

Sipas Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092, neni 32 paragrafi theksohet decidivisht se vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuara në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti Kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kriteret e tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: çmimin, meritat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse , efektiviteti i kostos, shërbimet pas shitjes dhe asistencë teknike.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka analizuar me kujdes dosjen e tenderit vëren se dosja standarde e aprovuar nga KRPP për furnizim- procedurë e hapur, për këtë aktivitet të prokurimit është modifikuar në kundërshtim me ligjin. Nëse e analizojmë dosjen e Autoritetit Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit pjesën II. Përshkrimi i çmimeve- Oferta Financiare tek tabela e kësaj dosje janë fshirë disa kolona të cilat janë të aprovuara në dosjen standarde për furnizim nga KRPP.

Veprimet e Autoritetit kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit dhe nenin 32 të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet të lejohen në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që t'i shmang praktikatat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

